

VENDIM
Nr. 39, datë 23.10.2024

**PËR NJË SHITESË NË METODOLOGJINË DHE PROCEDURËN PËR
MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE UJËSJELLËS-KANALIZIME**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 23.10.2024, pasi diskutoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit, mbi disa ndryshime në metodologjinë dhe procedurën për miratimin e tarifave të shërbimeve të Ujësjellës-Kanalizimeve të miratuar nga KKRR-ja, me vendimin nr. 539, datë 30.12.2021,

KONSTATOI SE:

1. Referuar VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, u parashikua që sektori UK të riorganizohet në 15 shoqëri UK rajonale nga 58 shoqëri UK. Aktualisht, janë krijuar dhe operojnë në sektor 14 shoqëri rajonale UK dhe 3 shoqëri UK ekzistuese.

2. Në nenin 6, “Politika e ndërfinancimit midis klientëve”, të metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, citohet se shoqëritë mund të propozojnë tarifa të diferencuara ndërmjet kategorive të ndryshme të klientëve, përkatësisht ndërmjet atyre familjarë dhe publikë e privatë (kategoritë “a”, “b” dhe “c”), por me tendencë rregullimin gradual të ndërfinancimit të tyre, me qëllim që raporti maksimal ndërmjet tarifave të klientëve publikë e privatë me ata familjarë nuk duhet të jetë më i madh se 2 (dy).

3. Gjatë analizës tekniko-ekonomike të aplikimeve për nivel të ri tarifor, referuar dhe riorganizimit të shoqërive UK, është konstatuar se ka diferenca midis tarifave ekzistuese të klientëve familjare me klientët jofamiljarë (publik dhe privat), duke e bërë të pamundur respektimin e koeficientit tarifor të përcaktuar në nenin 6, “Politika e ndërfinancimit midis klientëve” gjatë propozimit për nivel të ri tarifor.

4. Nisur nga riorganizimi i sektorit dhe i studimit të kryer mbi tarifat ekzistuese që aplikohen aktualisht, pritet që edhe shoqëri të tjera UK Rajonale, të cilat do të aplikojnë për nivel të ri tarifor të paraqesin të njëjtën problematikë, sa u përket diferencave më shumë se dy ndërmjet klientëve familjare dhe jofamiljare (publik dhe privat).

Komisioni Kombëtar Rregullator, duke pasur parasysh situatën aktuale të riorganizimit në sektorin UK, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se vendimi nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve”, është miratuar përpara fillimit të reformës në sektorin UK, vlerësoi nevojën për rishikimin e pikës 1 të nenit 6 të metodologjisë së tarifave.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pika 1 e nenit 6, “Politika e ndërfinancimit midis klientëve”, të metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjellës-kanalizime, bëhet si më poshtë:

1. a) Shoqëritë mund të propozojnë tarifa të diferencuara ndërmjet kategorive të ndryshme të klientëve, përkatësisht ndërmjet atyre familjarë dhe publikë e privatë (kategoritë “a”, “b” dhe “c”), por me tendencë rregullimin gradual të ndërfinancimit të tyre, me qëllim që raporti maksimal ndërmjet tarifave të klientëve publikë e privatë me ata familjarë nuk duhet të jetë më i madh se 2 (dy).

1. b) Politika e parashikuar në pikën 1(a) nuk do të jetë detyruese, në rastet kur tarifat ekzistuese të aplikuara nga shoqëritë ujësjellës-kanalizime, në raport me tarifat e propozuara nga shoqëritë UK, ndërmjet kategorive të klientëve familjarë me ato jofamiljarë (publik, privat) nuk respektojnë koeficientin 2 (dy).

Ky vendim hyn në fuqi me menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR

Evis Shurdha